



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 21

Prishtinë, më 15.9.2015, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Fikrim Damka, Emilija Redzepi, Lahi Brahimaj, Haxhi Shala, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Shaip Muja, Srdjan Popoviq.

Munguan : Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit të mbajtur më 29.7.2015,
3. Shqyrtimi në parim i projektligjit për zonën e obilqit
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të dites

Kryesuesi Fikrim Damka përshëndeti anëtarët e komisionit duke uruar punë të mbarë në sesionin vjeshtor dhe konstatoi se rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29.7.2015

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi Projektligjit për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rrethinën e tij

Kryesuesi Fikrim Damka përshëndeti kryetarin e komunës Obiliq **Xhafer Gashi** i cili nuk është ftuar nga komisioni por prezantoi në mbledhje për shkak të interesimit në cilësinë e zyrtarit të parë në atë komunë, njëherit sqaroi se ky projektligj është hartuar nga ky komision në legjislaturën e kaluar, por për shkak se nuk ka arritë të përfundoi, është proceduar prapë në këtë komision me ndihmën e 47 nënshkrimeve të deputetëve. Kryetari i Obiliqit falënderoi për qasjen e këtij komisioni dhe shkurtimisht sqaroi pse është i rëndësishëm ky ligj për komunën e Obiliqit. Territori i kësaj komune 72% shfrytëzohet nga KEK-u, ndaj më në fund shteti duhet të institucionalizoi mbrojtjen e komunës i cili më së tepërmi i jep Kosovës.

Shaip Muja përkrahu projektligjin duke konstatuar se është i vonuar , ndaj deri në leximin e dytë duhet të përmbliidhen edhe projektet tjera që janë në procedurë që kanë lidhje me këtë projektligj dhe të përfundojnë sa më parë në favor të kësaj komune të ndotur dhe të shfrytëzuar nga KEK, dhe e cila komunë është e rëndësishme për Kosovën sidomos edhe për Prishtinën e cila kontaminohet nga kjo komunë.

Adem Salihaj përveç që ceku rëndësinë e këtij ligji shtoi edhe faktin e kostos së ligjit ngase duhet të definohet kush do të finasoje ligjin, njëherit i lexoi vërejtjet me shkrim që i ka që ishin më tepër gjuhësore : Neni 3 pika 1.5 duhet të jetë mjedis e jo rrethinë, 1.9 nuk duhet të figurojnë kllapat, Neni 4 nuk duhet të cek fjalën venbanimet por ti numëroi cilat janë ato, pastaj të thuhet nga burimi i ndotjes e jo nga qendra. Kryesuesi falënderoi dhe shtoi se këtu duhet një amendament, por pas leximit të parë.

Lahi Brahimaj gjithashtu apeloj për urgjencën e këtij ligji dhe në ligj mos të ceket ndarja e komunës në tre zona, te Neni 5, ngase Obiliqi duhet të shënohet si një zonë.

Haxhi Shala tha se vet prezenca e kryetarit të komunës tregon se sa është me rëndësi ky ligj, ndaj ky fakt duhet të shtyj komisionin për veprim të shpejt duke mos u lëshuar në këtë takim në gabime teknike, sepse ato rregullohen menjëher

pas leximit të parë. Të njejtin përmbajtje kishte edhe diskutimi i **Srdjan Popoviq** i cili potencoi randësinë e ligjit, fillimisht për shëndetin e popullatës dhe ashtu me radhë. **Ndërhyrje** të vogël kishte z. Gashi i cili tha se tek Neni 5 është shkruar nga qendra sepse ajo është në mes dy elektraneve, por nuk kundërshtoi që ajo mund të zavendësohet me tërësinë territoriale, gjithashtu të mbetet zonë territoriale pa potencuar sa zona.

Me votim unanim komisioni vendosi :

R e k o m a n d i m

Kuvendi të miratoj në parim Projektligjin Nr. 05/L-044 për Zonën e rrezikuar të Obiliqit dhe rreth tij.

4. Të ndryshme

Kryesuesi Fikrim Damka sugjeroi për temat të cilat e presin Komisionin dhe propozoi mundësisht të vendoset rreth tyre, si vijon :

1. **Rreth shkresës së ZRRUK** ku kërkohet urgjencë për emërimin e zyrtarëve të lartë në këtë zyre, kishte diskutime që dallonin, **Fikrim Damka** ishte për solucionin që të kërkohet nga Qeveria urgjencë për emërimin e tyre, ngase kompanitë mbesin pa licenca, **Shaip Muja** tha se kjo shkresë vjen nga grupet që luftojnë për këto dy vende prandaj edhe ky problem shkon sipas tyre deri në skandalizim, shembull mori Batllavën ku u ndërrua drejtori, prandaj ky komision sipas tij nuk duhet të involvohet duke sjell qëndrime për miltanta politik, poashtu ceku se stafi duhet të përgadit shkresë kronologjike nga e cila mund të shihet përgjegjësia e institucioneve për problemet që mund të shfaqen rreth ujit përkatësisht mungesës së ujit për shkak të jolicencimeve, **Adem Salihaj** tha se komisioni e ka ditë këtë problem, ndaj detyra e komisionit është të procedoj sa më shpejt ligjin për shërbimet e ujit, ska nevojë për këtë urgjencë nga komisioni, kryesuesi z. Damka tha se komisioni nuk ka fajsi për vonesën e ligjit. Rreth kësaj shkrese komisioni asgjë nuk mori qëndrim.
2. Lidhur me procedimin e **Projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit** u vendos që të vazhdoi GP takimet më 21.9.2015 në orën 11,00, gjithashtu kryetari njoftoi për takimin me ambasadoren e Zvicrrës rreth një vizite studimore në Zvicër apo në rajon diku në ndonjë vend ku ka ngjashmëri me zyren rregullator për ujëra,
3. Pas kthimit të përgjegjeve nga ministria e bujqësisë rreth **monitorimit të ligjit për inspektoratin bujqësor**, u sugjerua kryesuesi i GP Salih Salihu të vazhdoi me procedimin e këtij monitorimi sipas planit të hartuar,

4. Komisioni në këtë 6 mujor do të vazhdoi gjithashtu me monitorimin e **ligjit për ujëra** sipas planit të komisionit,
5. **Monitorimi i gjigantve ndotës** Sharrcem etj , sipas kryesuesit të GP z. Shaip Muja , së shpejti do të vazhdoi me vizitën e parë në javën tjetër në Sharrcem, Ferronikël dhe Obiliq duke eliminuar Trepçën për shkak të problematikës gjeografike dhe problemit politik. Ai ishte i mendimit që rekomandimet për Kuvend duhet të përfundojnë diku në muajin nëntor,
6. **Rreth raportit të grurit** nga ky komision, nga kryesia e kuvendit të kërkohet që ti drejtohet Qeverisë pse nuk ka ndonjë veprim konkret ende, përkundër afatit tre mujor që i është dhënë në përfundimet e rekomandimeve. Lidhur me këtë kërkesë polemizoi **Shaip Muja** i cili tha se ministri i një digasteri është sikurse kryeministri për Qeveri, që do të thotë se komisioni duhet ti drejtohet ministrit të bujqësisë, mirëpo **Adem Salihaj** dhe **Fikrim Damka** ishin të mendimit që pikrisht Kryeministrit duhet të drejtohet komisioni, ngase AVUK është në zyrën e kryeministrit, ndërkaq nëse hyn AVUK në kuadër të MB atëherë vlen ajo çka flet z. Muja,
7. **Rreth monitorimit të Ligjit për Kadastër** sipas propozimit të **Murat Hoxhës** komisioni mori qëndrim që krejt varet nga puna në këtë komision, dmth nëse ka kohë edhe ky monitorim do të përfshihet në agjendën e komisionit. Në kuadër të kësaj teme Shaip Muja parashtroi pyetjen “kush na solli ujkun në torishtë”, ndërsa Murat Hoxha tha se në caktimin e kufirit ka pasur gabime deri në atë masë sa që fjala është për kufirin e ri të caktuar, por nuk tha se për sa hektar tokë është fjala,
8. **Rreth eksportit të patateve në Malin e Zi**, të kërkohet nga AVUK përgjegje, pse është kthyer ky mall dhe ku ka shkua pastaj i njëjti mall.

Mbledhja përfundoi në orën 12,00.

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka